



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1427/Prot.
1

Tiranë, më 12.09.2025

VENDIM

Nr. 43, Datë 12.09.2025

PËR

**RIALOKIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË
TË STUDIMEVE BACHELOR, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË FAKULTETIN
E ARTIT SKENIK, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, nenin 69 e në vijim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nisur nga kërkesa e Përgjegjësit të Njesisë Bazë Skenografi-Kostumografi dhe Koreografi, përcjellë përmes Dekanit të Fakultetit të Artit Skenik me shkresën nr. 1427 prot., të 12.09.2025 dhe me lëndë “Kërkesë për rialokim kuote në ciklin e parë të studimeve Bachelor”, për kuotat e miratuara nga Senati Akademik me Vendimin Nr. 12, datë 04.02.2025 “Për deklarimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve, Master i Shkencave dhe Master Profesional për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve”, pasi diskutoi kërkesën e FAS,

VENDOSI:

1. Rialokimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë Bachelor, për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve, si më poshtë:
 - Programi i studimit Koreografi merr 2 (dy) kuota të pashfrytëzuara nga kuotat “Nga trojet sipas shteteve” të programit të studimit Koreografi.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca si dhe të përcillet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald Bakalli

Prof. Najada Hamza

Prof. Arben Llozi

Prof. Miltiadh Kutari

Prof. Sadik Spahija

Prof. Lorenc Radovani

Prof. Vladimir Myrtezaj (Grosha)

Prof. Endri Sina

Prof. Rudina Ciko

Prof. Gazmend Gjoka

Prof. Asoc. Dorian Çene

Prof. Asoc. Albes Fusha

Prof. Asoc. Edmond Gjikapulli

Prof. Asoc. Kristina Laço

Prof. Asoc. Genci Fuga

Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea Trimi (Student FAB)

Rei Kita (Student FM)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
DEKANI

Nr. 1427 Prot.

Tiranë, më 12/09/2025

Lënda: Kërkesë për rialokim kuote në ciklin e parë të studimeve Bachelor

REKTORIT TE UNIVERSITETIT TE ARTEVE

Prof.Dr. Erald BAKALLI

**DEPARTAMENTI
SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE KOREOGRAFI**

Zoti Rektor!

Në vijimësi të komunikimeve tona, dëshiroj që nëpërmjet kësaj shkrese të kërkoj nga ana Juaj, rialokim të 2 (dy) kuotave në **Ciklin e Parë të studimeve Bachelor** në programin e studimit **KOREOGRAFI** në Fakultetin e Artit Skenik.

Duke parë rezultatet e konkurrentëve në konkursin e pranimi në programin e studimit **KOREOGRAFI** vlerësimi me pikë i 2 (dy) kandidatëve poshtë vijës së kuqe janë:

Konkurrenti pare 110.76 pikë

Konkurenti dytë 104.54 pikë

Në Vendimin e Senatit Akademik të UART nr.11 datë 07/02/2024 "*Për deklarimin e kuotave të pranimi të studentëve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve / Master i Shkencave dhe Master Profesional për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve*", për ciklin e parë të studimeve Bachelor në Fakultetin e Artit Skenik janë miratuar në total 101 (njëqindë e një) kuota për kategori të ndryshme.

Nga këto kuota janë realizuar për kandidatët brenda territorit të vëndit 33 (tridhjetë e tre) kuota, nga 46 (dyzetë e gjashtë) të miratuara.

Gjithashtu vë në dukje se nga kuotat për trojet nuk janë shfrytëzuar nga asnjë nga programet. Nga Trojet kanë ngelur pa u shfrytëzuar 30 (tridhjetë) të përcaktuara në vendimin e mësipërm të Senatit Akademik të UART.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nisur nga sa më sipër si dhe nga fakti se në programin e studimit **KOREOGRAFI** vlerësimi me pikë i DY kandidatëve poshtë vijës së kuqe, pjesëmarrës në konkurs, është në nivelin e mbi 90 (nëntëdhjetë) pikëve, pra mbi pragu e përcaktuar me vendimin e Senatit Akademik nr 12 datë 07/02/2024 *“Mbi përcaktimin e pikëzimit në konkurset e pranimit për ciklin e parë të studimeve dhe ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë në UART, për vitin akademik 2025-2026”*, Departamenti Skenografi-Koreografi ka paraqitur një kërkesë për rialokim kuotash dhe konkretisht kërkojnë:

- **2 (dy) kuota të pashfrytëzuara në programet e studimit Koreografi nga kuotat e (Trojeve) të kalojnë në dobi të programit të studimit Koreografi, për studentet me pikët fitues.**

Bashkangjitur po ju dërgoj edhe kërkesën e Departamentit.

Ju faleminderit.

Prof. **Milutash KUTALI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
DEPARTAMENTI SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE KOREOGRAFI

TIRANË 10 /09/2025

LËNDA: Kërkesë për rialokim kuote në programin e studimit Koreografi

DEKANIT TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK
Prof. Miltiadh KUTALI

Zoti Dekan!

Duke parë kërkesat e shumta për programin e studimit Koreografi, ne si departament konkluduar mbi mundësin e shfrytëzimit të kuotave të pashfrytëzuara të Trojeve për studentët me pikët fituese në konkursin e pranimit për ciklin e parë të studimeve bachelor për vitin akademik 2025-2026. Në programin e studimit Koreografi u shpallën 10 fitues nga konkursi zhvilluar me datën 20-21 Gusht, nga 10 kuota të kërkuara në senat.

Meqënëse dy kandidatë poshte vizës së kuqe dolën me pikë fituese në konkursë kërkojmë dy kutoat nga trojet, të cilat nuk janë shfrytëzuar nga të 5 programet e tjera.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Prof.asoc. Taulant PUSTINA

Përgjegjës i departamentit